



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 7, datë 28.01.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA**  
**FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN JANAR 2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 89 familje me një fond prej 291.940 ( dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.
2. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej 8 familje nga fondi i Bashkisë si më poshtë:

✓ **Njësia Administrative Nr. 3**

Marinela Osmani Mosplotësim dokumentacioni.

✓ **Njësia Administrative Nr. 5**

Suela Balla Merr pagesë invaliditeti.  
Shpëtim Koka Vdekur  
Gëzim Gashi Mosplotësim dokumentacioni.  
Drita Aliaj Mosplotësim dokumentacioni.  
Marinela Toshi Mosplotësim dokumentacioni.

✓ **Njësia Administrative Sukth**

Marinela Kurti Mosplotësim dokumentacioni.  
Xhemali Faslliu Mosplotësim dokumentacioni.

3. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Janar 2022 të 6 (gjashtë) familjeve, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë:

✓ **Njësia Administrative Nr. 3**

Arif Bajrami Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë.  
Eva Velishtari Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë.  
Albert Cerma Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë.

✓ **Njësia Administrative Nr. 5**

Esmeralda Yzi Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2700 lekë.

✓ **Njësia Administrative Sukth**

Erjon Drizi Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë.  
Vojsava Isaku Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3400 lekë.

4. Miratimin e rihyrjes në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia të 1(një) familjeje si më poshtë :

Sonila Dumani Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3600 lekë.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 31.01.2022**





BASHKIA DURRËS

28.02.22 258/7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 90/prot.

3

Durrës, më 06.02.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.7 datë 28.01.2022: "Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë Durrës për muajin Janar 2022"

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

